



CREASSE.EU



This project has been funded with support from the European Commission under the Erasmus+ Programme. This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein. Project number: 2024-1-ES01-KA220-ADU-000256807.



Co-funded by
the European Union



CREASSE

MANUAL PRAKTIK "PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE NË SIPËRMARRJEN KOLEKTIVE": ROLI I LEHTËSUESIT SOCIAL

UDHËZIME PËR MONITORIMIN, VLERËSIMIN DHE RAPORTIMIN E AKTIVITETEVE

TABELA E PËRMBAJTJES



Udhëzues për Ndjekjen, Vlerësimin dhe Raportimin

- | | |
|--|---|
| • Përmbledhje e Shkurtër | 1 |
| • Objektivat e Modulit | 2 |
| • Udhëzime Haps - Pas - Hapi për Lehtësuesit | 3 |
| • UshtrimReflektimi | 5 |



UDHËZUES PËR NDJEKJEN, VLERËSIMIN DHE RAPORTIMIN

Përmbledhje e Shkurtër

Ky udhëzues është pjesë e projektit CREASSE dhe është hartuar për të mbështetur lehtësuesit socialë në fazën përfundimtare të ciklit të lehtësimit, duke siguruar që rezultatet e të mësuarit, proceset e angazhimit dhe ndikimi në komunitet jo vetëm të dokumentohen, por edhe të reflektohen në mënyrë kuptimplotë dhe të shërbejnë si bazë për veprime të mëtejshme.

Udhëzuesi përputhet me qëllimin më të gjerë të Manualit: mundësimin e mësimit gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës, dhe ndërtimin e kapaciteteve për sipërmarrjen kolektive dhe sociale. Ai integron konceptet kryesore nga Paketa e Mjeteve (Toolbox) në të katër fushat e kompetencave (Personale, Sipërmarrëse, të Gjelbërta dhe Inovative) dhe u ofron lehtësuesve socialë mjete për të vlerësuar, raportuar dhe ndjekur në mënyrë efektive rezultatet e sesioneve të trajnimit, eventeve të rrjetëzimit, aktiviteteve të mentorimit dhe zhvillimit të projekteve në fushën e Ekonomisë Sociale dhe Solidare.

Objektivat e Modulit

- Të monitorojë dhe dokumentojë arritjet e të mësuarit dhe nivelin e angazhimit.
- Të vlerësojë rëndësinë, cilësinë e procesit dhe ndikimin e aktiviteteve të lehtësimit.
- Të ofrojë mjete dhe formate/modele për raportim të strukturuar.
- Të mundësojë mbështetje dhe lidhje të vazhdueshme me pjesëmarrësit përmes mekanizmave të ndjekjes.
- Të sigurojë koherencë me kompetencat e përshkruara në Paketën e Mjeteve të CREASSE dhe në të gjitha modulet e Manualit.

Temat Kryesore të Trajtuar:

- Teknikat e vlerësimit formues dhe përmbledhës.
- Tregues të bazuar në kompetenca.
- Qasje të strukturuar për raportim.
- Praktikat etike të ndjekjes pas aktivitetit.
- Mbledhja e historive të suksesit dhe mësimave të nxjerra.

Mjetet dhe Materialet e Nevojshme:

- Formularët e vlerësimit të pjesëmarrësve (print / digjital).
- Fletë për ndjekjen e kompetencave (bazuar në fushat e Paketës së Mjeteve).
- Mjete për dokumentim vizual (kamera, regjistruar audio).
- Modele raportimi (lista e pjesëmarrësve, përmbledhja e rezultateve, pjesëmarrja).
- Kriteret e vlerësimit.
- Mjete online për anketime (p.sh., Google Forms, Typeform).

Udhëzime Hap Pas Hapi për Lehtësuesit

Hapi 1: Përcaktoni Fokusin e Vlerësimit - Identifikoni se cilat kompetenca dhe rezultate (të lidhura me modulin e ofruar) po vlerësohen.

Hapi 2: Mblidhni Vlerësimin e Pjesëmarrësve - Përdorni anketa, diskutime me gojë ose mjete reflektimi në grup menjëherë pas çdo seance.

Hapi 3: Dokumentoni vëzhgimet - Përdorni dtarë të lehtësuesve për të shënuar vëzhgime mbi sjelljen, niveleln e pjesëmarrjes, dhe sfidat.

Hapi 4: Vetëvlerësimi dhe vlerësim nga bashkëmoshatarët - Ftojini pjesëmarrësit të vlerësojnë kontributet e tyre dhe të të tjerëve.

Hapi 5: Reflektoni dhe përgatisni raportin - Përmbledhni mësimet, arritjet, sfidat dhe rekomandimet duke përdorur formate të strukturuar.

Hapi 6: Ndani dhe ndiqni raportet - Shpërndani raportet me partnerët ose financuesit; rilidhuni me pjesëmarrësit përmes mentorimit, takimeve pasuese ose aktiviteteve të planifikimit bashkëpunues.

Metodat e Vlerësimit dhe Indikatorët/Treguesit

Metodat:

- Feedback i shkruar ose verbngja pjesëmarrësit.
- Sondazhe oale se lista kontrolli para/pas.
- Vlerësime nga kolegët dhe rishikime nga lehtësuesit.

Indikatorët:

- Niveli i kënaqësisë me sesionin e trajnimit/modulin.
- Përmirësim i raportuar në kompetencat kryesore (cilësore dhe sasiore).
- Numri i produkteve të përfunduara (p.sh., canvas projekti, prezantim).
- Pjesëmarrja e vëzhguar dhe dinamika e grupit.
- Dëshmi e angazhimit pas aktivitetit (p.sh., përfshirja në mentorim, zhvillimi i ideve).

Formate dhe Mjete

Formatet e disponueshme:

- Formati i Raportit të Sesioneve të Trajnimit
- Formular Vlerësimi për Pjesëmarrësit
- Forma Vetëvlerësimit të Kompetencave
- Forma Pyetësi për Ndjekjen pas aktivitetit
- Fletë për mbledhjen e Historive të Suksessit

Reflektim dhe Mësim i Vazhdueshëm

Inkurajoni lehtësuesit që të:

- Reflektojnë mbi rolin e tyre, zhvillimin dhe stilin e tyre të lehtësimit.
- Ndajnë komentet/reagimet me kolegët për mësimin e ndërsjelltë.
- Përdorni raportimin jo vetëm për llogaridhënie, por edhe si një cikës mësimi për dizenjimin e sesioneve të ardhshme.
- Nxisin bashkëpunimin afatgjatë përmes komuniteteve të përbashkëta të nxënësve dhe hapësirave digjitale.

Ushtrime Reflektimi

Bëjini vetes (ose ekipit tuaj) pyetjet e mëposhtme me përgjigje të hapura pas përfundimit të një moduli trajnimi ose një aktiviteti lehtësues të SSE-së. Përdorini ato për të vlerësuar përvojën tuaj të lehtësuesit dhe për të identifikuar fushat për zhvillim personal dhe profesional.

1. Cilat ishin ndryshimet ose momentet më kuptimplota të rritjes që vutë re te pjesëmarrësit?
2. Cilat mjete ose metoda funksionuan më mirë për angazhimin e pjesëmarrësve dhe pse?
3. Sa mirë u reflektuan kompetencat nga Paketa e Mjeteve (Toolbox) në qasjen tuaj të lehtësimit?
4. Çfarë sfidash hasët gjatë vlerësimit ose raportiimit dhe si i adresuat ato?
5. Si mund ta përmirësoni sesionin tjetër të lehtësimit (p.sh., strukturën, kohën, përmbajtjen, ndërveprimin)?
6. Çfarë mësuat për veten si lehtësues gjatë gjithë këtij procesi?
7. Cilat lidhje ose ide të komunitetit do të dëshironit të vazhdonit të mbështesnit pas projektit?

Inkurajoni përgjigjet me shkrim ose përdorni pyetjet në një sesion feedback-u midis lehtësuesve. Kjo ndihmon në ndërtimin e një kulture të të mësuarit të vazhdueshëm dhe praktikës reflektive.